

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Sh.a. Ujesjelles Kanalizime Erseke

SPECIFIKIME TEKNIKE

Vendosje matesash e rikonstruksion i linjave te jashteme e te brendshme te fshatrave Borove, Taç Siper Agalli e Mesicke, Bashkia Kolonje.

I. HYRJE

Ky "Specifikim Teknik", si dokument kontraktual, eshte hartuar nga grupi i projektimit per projektin **Vendosje matesash e rikonstruksion i linjave te jashteme e te brendshme te fshatrave Borove, Taç Siper Agalli e Mesicke, Bashkia Kolonje.**

Zerat e rradhitur ne permbajtje, jane pjese e pershkrime te detajuara te vizatimeve te bera nga grupi i projektuesve si dhe specifikime te tjera te mundshme te kategorive te ndryshme punimesh. Standartet e perdorura ne kete dokument "Specifikimet Teknike", nuk jane mbeshtetur vetem ne vizatimet por edhe ne manualet ligjore dhe libra te tjere keshillues si:

1. Manualet dhe Analizat Teknike per prodhimin e materialeve te ndertimit, Udhezime dhe Kriteria .
2. Kushtet Teknike te Projektimit dhe Zbatimit ne Fuqi

Shenime:

Keto Specifikime Teknike nuk mund te perdoren per projekte apo aktivitete te cilat nuk jane pjese e projektit Rikonstruksion i Ujesjellesit te qytetit Leskovik (Linja kryesore Kronjeza –Rezervuaret Ujembledhes)", pa lejen e projektuesve, kjo eshte e nevojshme edhe kur behen ndryshime dhe pershtatje ne keto specifikime. Subjekte te perfshira ne projektin e mesiperm mund te bejne sygjerrime per permiresimin ose ndryshimin e ketyre specifikimeve nese kerkohet nga ndryshime te mundshme te kategorive te punimeve ose mungesa e detajeve apo pershkrimeve te ndonje zeri. Sygjerimet duhet te mbeshteten ne kriteret teknike ligjore, rregulla dhe standarte te paraqitura ne manualet apo librat perkatese e te paraqiten me shkrim.

II. TE PERGJITHESHME

Paragrafet ne kete kapitull jane plotesuese te detajeve te dhena ne Kushtet e Kontrates.

1.1 Zevendesimet

Zevendesimi i materjaleve te specifikuara ne Dokumentin e Kontrates do te behen vetem me aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve ne se materjali i propozuar per tu zevendesuar eshte i njejte ose me i mire se materjalet e specifikuara; ose ne se materjalet e specifikuara nuk mund te sillen ne sheshin e ndertimit ne kohe per te perfunduar punimet e Kontrates per shkak te kushteve jashte kontrollit te Kontraktuesit. Qe kjo te merret ne konsiderate, kerkesa per zevendesim do te shoqerohet me nje dokument deshmi te cilesise, ne formen e kuotimit te certifikuar dhe te dates se garancise te dorezimit nga furnizuesit i te dy materjaleve, si te materialit te specifikuar ashtu edhe te atij qe propozohet te ndryshohet.

1.2 Dokumentat dhe vizatimet

Kontraktuesi do te verifikojë te gjitha dimensionet, sasite dhe detajet e treguar ne Vizatimet, Grafiket, ose te dhena te tjera dhe Punedhenesi nuk do te mbaje pergjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtësojë Kontraktuesin nga pergjegjesia per pune te pakenaqeshme. Kontraktuesi do te marre persiper te gjithë pergjegjesine ne berjen e llogaritjeve te madhesive, llojeve dhe sasive te materialeve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga Punedhenesi ne se gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

1.3 Kostot e Kontraktuesit per mobilizim dhe punime te perkoheshme

Do te kihet parasysh qe Kontraktuesit nuk do ti behet asnje pagese mbi çmimet njesi te kuotuar per kostot e mobilizimit d.m.th. per sigurimin e transportit, drite, energji, veglat dhe pajisjet, ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertuara nga sipermarsi, ose te komoditeteve sanitare heqje e mbeturinave, furnizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme, pajisje dhe materiale, ose per kujdesin mjeksor dhe mbrojtjen e shendetit, ose per patrullat dhe rojet, ose per ndonje sherbim tjetër, lehtësi, gjera, ose materiale te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate.

1.4 Hyrja ne sheshin e ndertimit

Kontraktuesi duhet te organizojë punen per ndertimin, mirembajen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose cdo rruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e punimeve. Çvendosja do te perfshije pershtatjen e zones me cdo rruge hyrje dhe me shkalle sigurie, qendrushmerie dhe te kullimit te ujrave siperfaqesore te njejte me ate qe ekzistonte perpara se Kontraktuesi te hynte ne Shesh.

1.5 Furnizimi me uje

Uji, qe nevojitet per zbatimin e punimeve, do te merret nga rrjeti kryesor nepermjet nje matesi ne piken me te afert te mundeshme. Kontraktuesi do te shtrijë rrjetin e vet te perkoheshem te tubacioneve. Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot per kete do te paguhen nga Kontraktuesi. Ne rastet kur nuk ka mundesi lidhje me rrjetin kryesor, Kontraktuesi duhet te beje vete perpjekjet per furnizimin me uje higjenikisht te paster dhe te pijshem per punetoret dhe punimet.

1.6 Furnizimi me energji elektrike

Kontraktuesi me shpenzimet e tij do te beje perpjekjet per furnizimin me energji elektrike ne kantjer, si me kontraktim me OSHEE – ne, kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal jane te mundura, ose duke parashikuar gjeneratorin e vet per te permbushur kerkesat.

1.7 Piketimi i punimeve

Kontraktuesi me shpenzimet e tij duhet te beje ndertimin e modinave dhe te piketave siç kerkohet, ne perputhje me informacionin baze te Punedhenesit, dhe do te jete pergjegjesi i vetem per perpikmerine. Kontraktuesi do te jete pergjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe i eshte dhene dhe ne asnje menyre nuk do te lehtësohet nga pergjegjesia e tij ne se nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik ose jo korrekt. Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhenesi, dhe ne asnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshime ne vizatimet e kontrates , per asnje lloj kompensimi per korrigjimet e gabimeve ose te mangesive. Kontraktuesi do te furnizojë dhe mirembaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale te tjera te tilla dhe te jape asistenca nepermjet nje stafi te kualifikuar siç mund te kerkohet nga Punedhenesi per kontrollin e modinave dhe piketave. Kontraktuesi do te ruaje te gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, te bera ose te vendosura gjate punes, te mbuloje koston e rivendosjes se tyre nese ato demtohen dhe te mbuloje te gjitha

shpenzimet per ndreqjen e punes se bere jo mire per shkak te mosmirembajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim te ketyre pikave te vendosura, modinave dhe piketave. Perpara çdo aktiviteti ndertimor, Kontraktuesi do te kete linjat e furnizimit me uje dhe energji elektrike te vendosura ne terren, te drejten e kalimit te qarte dhe te sheshuar, gati per fillimin e punimeve. Çdo pune e bere jasht akseve, kuotave dhe kufijve te treguara ne vizatime ose te mosmiratuara nga Punedhenesi nuk do te paguhet, dhe Kontraktuesi do te mbuloje me shpenzimet e tij germimet shtese gjithmone nen drejtimin e Mbikqyresit te Punimeve.

1.8 Fotografite e sheshit te ndertimit

Kontraktuesi duhet te beje forografi me ngjyra sips udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve ne vendet e punes per te demonstruar kushtet e sheshit perpara fillimit , progresin gjate punes se ndertimit dhe mbas perfundimit te punimeve. Nuk do te behen pagesa per fotografimin e kantierit te punimeve pasi keto shpenzime jane parashikuar te mbulohen nen koston administartive te Kontraktuesit.

1.9 Bashkepunimi ne zone

Ndertimi do te behet ne zona te kufizuara. Kontraktuesi duhet te kete veçanerisht kujdes ne:

- a) nevojën për të mirëmbajtur shërbimet ekzistuese dhe mundësitë e kalimit për banorët dhe tregëtarët që janë në zonë, gjatë periudhës së ndërtimit.
- b) prezencën e mundeshme të kontraktoreve të tjerë në zonë me të cilët do të koordinohet puna në një mënyrë të tillë, që të lejojë hyrjen dhe përballimin e të gjithë pajisjeve të mundeshme për ndonjë Kontraktor tjetër dhe punëtorëve të tij, stafin e Punedhënesit si edhe të çdo punonjësi që mund të përdoret në zbatim dhe/ose punimet në zonë ose prane saj për çdo objekt që ka lidhje me Kontraten ose çdo gjë tjetër. Në përgatitjen e programit të tij të punës, Kontraktuesi gjatë gjithë kohës do të bëjë llogari të plote dhe do të koepërojë me programin e punës së Kontraktoreve të tjerë, në mënyrë që të shkaktojë një minimum interference me ta dhe me publikun.

1.10 Mbrojtja e punes dhe e publikut

Kontraktuesi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhe të jetës publike si edhe të pasurive në dhe rreth sheshit të ndërtimit. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikushme, kodeve të ndërtësive dhe të ndërtimit do të respektohen. Makineritë, pajisjet dhe çdo rrezik do të k'qyren ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit. Gjatë zbatimit të punimeve Kontraktuesi me shpenzimet e veta, duhet të vendosi dhe të mirëmbajë gjatë natës pengesa të tilla dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Kontraktuesi duhet të sigurojë pengesa të pershtatshme, shenja me dritë të kuqe "rrezik" ose "kujdes" dhe vrojtues në të gjitha vendet ku punimet mund të shkaktojnë çrregullime të trafikut normal ose që përbejnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun.

1.11 Mbrojtja e ambientit

Kontraktuesi me shpenzimet e veta, duhet të ndermarre të gjithë veprimet e mundshme për të siguruar që ambienti lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera . Mos plotesimi i kesaj klauzole ne baze te evidentimit nga Mbikqyresi i Punimeve, mund te coje ne nderprerjen e kontrates

1.12 Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i çdo materiali nga Kontraktuesi do të behet me makina të pershtatshme të cilat kur ngarkohen

nuk shkaktojnë dërdhje dhe e gjithë ngarkesa të jete e siguruar. Ndonjë makine që nuk plotëson këto kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri. Të gjitha materialet që sillen nga Kontraktuesi

duhet te stivohen ose te magazinohen ne menyre te pershtateshme per ti mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe ne dispozicion, per tu kontrolluar nga Mbikqyresi i Punimeve ne çdo kohe.

1.13 Sheshi per magazinim

Kontraktuesi duhet te beje me shpenzimet e tij marrjen me qira ose blerjen e nje terreni te mjaftueshem per ngritjen e magazinave me shpenzimet e tij.

1.14 Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet siç eshte zbatuar)

Kontraktuesi duhet te pergatise vizatimet per te gjitha punimet “siç jane faktikisht zbatuar” ne terren. Vizatimet do te behen ne nje standart te ngjashem me ate te vizatimeve te Kontrates. Gjate zbatimit te punimeve ne kantier, Kontraktuesi do te ruaje te gjithë informacionin e nevojshem per pergatitjen e “Vizatimeve siç eshte zbatuar”. Do te shenoje ne menyre te qarte vizatimet dhe te gjitha dokumentat e tjera te cilat mbulojne punen e vazhdueshme te perfunduar, material i cili do te jete i disponueshem ne cdo kohe gjate zbatimit per Menaxherin e Projektit. Keto vizatime do te azhurnohen ne menyre te vazhdueshme dhe do t'i dorezohen Mbikqyresit te Punimeve çdo muaj per aprovim. Materiali mujor do te dorezohet ne kopje leter. Vizatimet e riprodhuara do te perfshijne pozicionin dhe shtrirjen e te gjithë konstruksioneve mbajtese te lena gjate germimeve dhe vendosjen ekzakte te te gjitha sherbimeve qe jane ndeshur gjate ndertimit. Kontraktuesi gjithashtu duhet te pergatise seksionet e profilitt gjatesor te rishikuar, pajisur me shenimet qe tregojne shtresat e tokes qe hasen gjate te gjitha punimeve te germimit. Si perfundim, kopjet e riprodhuara te Vizatimeve “sic eshte zbatuar” do t'i dorezohen Mbikqyresit te Punimeve per aprovim. Vizatimet “sic eshte zbatuar”, te aprovuara, do te behen prone e Punedhenesit. Nuk do te behen pagesa per berjen e Vizatimeve “sic eshte zbatuar” dhe Manualeve, pasi kosto e tyre eshte parashikuar te mbulohet nga shpenzimet administrative te Kontraktuesit.

1.15 Provat

Ky seksion perfqeson procedurat e kryerjes se provave per materialet me qellim qe te sigurohet perputhja me kerkesat e Specifikimeve Teknike.

Tipi dhe Zbatimi i Provave

Do te kryhen provat e meposhtme:

- Permbajtja e Ujit
- Densiteti Specifik
- Indeksi i Plasticitetit
- Densiteti ne gjendje te thate (Metoda e Zevendesimit me Rere)
- Shperndarja Sipas Madhesise se Grimcave (Sitja)
- Proktori i Modifikuar dhe Normal
- CBR (California Bearing Ratio)
- Provat e Betonit (Thermimi i Kampioneve)

Standartet per Kryerjen e Provave

Te gjitha provat do te behen ne perputhje me metodat standarte shqiptare ose me te tjera nderkombetare te aprovuara.

Marrja e Kampioneve edhe Numri i Provave

Metoda e marrjes se kampioneve do te jete sic eshte specifikuar ne metodat e aplikueshme te marrjes se kampioneve dhe te kryerjes se provave ose siç udhezohet nga Mbikqyresit te Punimeve.

Frekuenca e kryerjes se provave do te perputhet me treguesit ne Specifikimet Teknike dhe nese nuk gjendet atje, do te jepet nga Mbikqyresi i Punimeve. Marrja e ndonje kampioni shtese mund te udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve. Ene te tilla si çanta, kova e te tjera, do te jepen nga Kontraktuesi. Marrja e kampioneve do te kryhet nga Kontraktuesi ne vendet dhe periudhat qe udhezoi Mbikqyresi i Punimeve. Marrja, transportimi e sjellja e tyre ne laborator do te behet nga Kontraktuesi.

Nderprerja e Punimeve

Nderprerja e punimeve per arsye te marrjes se kampioneve do te perfshihet ne grafikun e punimeve te Kontraktuesit. Nuk do te pranohet asnje ankese nga nderprerja e punimeve, per shkak te marrjes se kampioneve.

Provat ne laborator, do te behen ne nje kohe te pershtatshme me metoden e pershkruar. Provat e Kryera nga Kontraktuesi per arsye krahasimi, Kontraktuesi eshte i lire te kryeje vete ndonje prej provave. Rezultatet e provave te tilla do te pranohen vetem kur te kryhen ne nje laborator te aprovuar me shkrim nga Mbikqyresi i Punimeve. Te gjitha shpenzimet e provave te tilla pavaresisht se nga vijne rezultatet do te mbulohen nga Kontraktuesi.

1.16 Germimi i kanaleve per tubacionet

Kanalet do te germohen ne dimensionet dhe nivelin e e treguar ne vizatime dhe /ose ne perputhje me instruksionet me shkrim te Mbikqyresit te Punimeve. Zeri i treguar ne tabelen e Volumeve (Preventiv) lidhur me germimet, siç eshte largimi i materialit te germuar, etj. do te perfshije cdo lloj kategorie dheu, nese nuk do te jete specifikuar ndryshe. Germimi me krahe eshte gjithashtu i nevojshem ne afersi te intersektiveve te infrastrukturave te tjera per te parandaluar demtimin e tyre. Me perjashtim te vendeve te permendura me siper, mund te perdoren makinerite. Ne se nuk urdherohet apo lejohet ndryshe nga Mbikqyresi i Punimeve nuk duhet te hapen me shume se 30 metra kanal perpara perfundimit te shtrirjes se tubacionit ne kete pjese kanali. Gjeresia dhe thellësia e kanaleve te tubacioneve do te jete siç eshte percaktuar ne vizatimet e kontrates ose siç do te udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve. Thellimet per pjeset lidhese do te germohen me dore mbasi fundi i kanalit te jete niveluar. Pervec se kur kerkohet ndryshe, kanalet per tubacionet do te germohen nen nivelin e pjeses se poshteme te tubacionit siç tregohet ne vizatime, per te bere te mundur realizimin e shtratit te tubacioneve me material te specifikuar ne vizatime.

1.17 Perdorimi i Materialeve te germimit

Te gjitha materialet e pershtatshme dhe te aprovuara te germimit duhet, persa kohe qe ato jane praktike, te perdoren ne ndertim per mbushje dhe punime rruge.

1.18 Ndertimi i mbushjeve

1. Tabani

Tabani i dheut i shtresave rrugore dhe kanalit eshte pjese e trupit te dheut ku shperndahen nderjet e shkaktuara nga ngarkesat e levizshme te automjeteve dhe e vete konstruksionit. Ky taban mund te jete ne mbushje ose ne germim. Si ne njerin rast edhe ne tjetrin eshte e nevojshme qe te sigurohet nje taban, qe te jete ne gjendje te transmetoje me poshte, ne trupin e dheut ngarkesat qe vijne nga shtresat rrugore, pa pesuar deformime mbetese. Mbushja gjithandej duhet te kete nje densitet qe i referohet standartit AASHTO te modifikuar te jete max. ne te thate jo me pak se 90%, per shtresat e poshtme te ngjeshura dhe 95%, per shtresen e sipërme 30 cm (subgrade). Çdo shtrese duhet te ngjishet me lageshtine optimale duke shtuar ose thare shtresen sipas rastit dhe kerkeses se llojit te materialit qe do te perdoret ne mbushje te rruges. Çdo shtrese e re ne mbushje duhet te miratohet nga Mbikqyresit te Punimeve,

pasi te jete siguruar se shtresa paraardhese nuk ka deformacione ose probleme me burime uji apo lageshtire te tepert. Zgjedhja e pajisjeve te ngjeshjes eshte e lire te behet nga Kontraktuesi mjafton qe pajisjet ngjeshese te sigurojne energjine e nevojshme dhe te arrijne densitetet e kerkuara ne ngjeshje per shtresen ne ndertim.

2. Rimbushja e Themeleve

Te gjitha mbushjet per kete qellim duhet te behen me materiale te pershtatshme dhe te ngjeshen, vetem nese tregohet ndryshe ne Vizatime ose urdherohet nga Mbikqyresit te Punimeve.

3. Perforcimi i ndertesave

Si pjese e punes ne zerat e germimit Kontraktuesi, me shpenzimet e veta, do te perforcoje te gjitha ndertimet, muret si edhe strukturat e tjera qendrueshmeria e te cilave duhet te garantoje mosrrezikimin gjate zbatimit te punimeve dhe do te jete teresisht pergjegjes per te gjitha demtimet e personave ose te pasurive qe do te rezultojne nga aksidentet e ndonje prej ketyre ndertimeve, mureve ose strukturave te tjera. Neqofte ndonje nga keto pasuri, struktura, instalime ose sherbime do te rrezikohen ose demtohen si rezultat i veprimeve te Kontraktuesit, ai menjehere duhet te raportojë per keto rrezeqe ose demtime Menaxherin e Projektit si dhe autoritetet qe kane lidhje me te dhe menjehere te mare masa per ndreqjen gjithmone sipas pelqimit te Mbikqyresit te Punimeve ose te autoriteteve perkatese.

4. Perforcimi dhe veshja e germimeve

Nese germimi i zakonshem nuk eshte i mundur apo i keshillueshem, gjate germimeve duhet te vendosen struktura mbajtese per te parandaluar demtimet dhe vonesat ne pune si edhe per te krijuar kushte te sigurta pune. Kontraktuesi do te furnizojë dhe vendosë te gjitha strukturat mbajtese, mbulese, trare dhe mjete te ngjashme te nevojshme per sigurimin e punes, te publikut ne pergjithesi dhe te pasurive qe jane prane. Strukturat mbrojtese do te hiqen sipas avancimit te punes dhe ne menyre te tille qe te parandalojne demtimin e punes se perfunduar si edhe te strukturave e pasurive qe jane prane. Sapo keto te hiqen te gjitha boshlleqet qe mbeten nga heqja e ketyre strukturave duhet te mbushen me kujdes dhe me material te zgjedhur dhe te ngjeshur. Kontraktuesi do te jete krejtesisht pergjegjes per sigurimin e punes ne vazhdim, te punes se perfunduar, te punetoreve, te publikut dhe te pasurive qe jane prane. Kosto e perforcimit dhe veshjes se germimeve eshte perfshire ne çmimin njesi per germimet.

5. Mirembajtja e germimeve

Te gjitha germimet do te mirembahen siç duhet nderkohe qe ato jane te hapura dhe te ekspozuara, si gjate dites ashtu edhe gjate nates. Pengesa te mjaftueshme, drita paralajmeruese, shenja, si edhe mjete te ngjashme do te sigurohen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi do te jete pergjegjes per ndonje demtim personi ose pronesie per shkak te neglizhences se tij.

6. Largimi i ujerave nga punimet e germimit

Si pjese e punes ne zerat e germimit dhe jo me kosto plus per Punedhenesin, Kontraktuesi do te ndertoje te gjitha drenazhimet dhe do te realizojë kullimin me kanale kulluese, me pompim ose me kova si edhe te gjithë punet e tjera te nevojshme per te mbajtur pjesen e germuar te paster nga ujerat e zeza dhe nga ujera te jashme gjate avancimit te punes dhe deri sa puna e perfunduar te jete e siguruar nga demtimet. Kontraktuesi duhet te siguroje te gjitha pajisjet e pompimit per punimet e tharjes se ujit si edhe personelin operativ, energjine e te tjera, dhe te gjitha keto pa kosto shtese per Punedhenesin. I gjithë uji i pompuar ose i drenazhuar nga vepra duhet te hiqet ne nje menyre te aprovueshme prej Mbikqyresit te Punimeve. Duhet te merren masa paraprake te nevojshme kunder permbytjeve .

7. Perforcimi dhe mbulimi ne vend

Punedhenesi mund te urdheroje me shkrim qe ndonje ose te gjitha perforcimet dhe strukturat mbajtese te lihen ne vend me qellim te masave paraprake per mbrojtjen nga demtimet te strukturave, te pronesive te tjera ose personave, nese keto struktura mbajtese jane shenuar ne vizatime ose te vendosura sipas udhezimeve, ose nga ndonje arsye tjeter. Nese lihen ne vend keto struktura mbrojtese do te priten ne lartesine sipas udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve. Strukturat mbajtese qe mbeten ne vend do te shtrengohen mire dhe do te paguhen sipas vlerave qe do te

bihet dakort reciprokisht ndermjet Kontraktuesit dhe Punedhensesit ose sipas cmimit ne Oferte nqs eshte dhene, ose nga nje urdher ndryshimi me shkrim.

8. Mbrojtja e sherbimeve ekzistuese

Kontraktuesi do te kete kujdes te vecante per sherbimet ekzistuese qe jane nen siperfaqe te cilat mund te ndeshen gjate zbatimit te punimeve dhe qe kerkojne kujdes te vecante per mbrojtjen e tyre , si tubat e kanalizimeve, tubat kryesore te ujesjellesit, kabllot elektrike kabllot e telefonit si dhe bazamentet e strukturave qe jane prane. Kontraktuesi do te jete pergjegjes per demtimin e ndonje prej sherbimeve si dhe duhet t'i riparoje me shpenzimet e tij, nese keto sherbime jane ose jo te paraqitura ne projekt. Nese autoritetet perkatese pranojne te rregullojne vete ose nepermjet nje nen Kontraktuesi te emruar nga ai vete demet e shkaktuara ne keto sherbime, Kontraktuesi do te rimbursojte te gjitha koston e nevojeshme per kete riparim, dhe ne se ai nuk ben nje gje te tille, keto kosto mund ti zbriten nga çdo pagese qe Punedhensei ka per ti bere ose do ti beje Kontraktuesit ne vazhdim te punimeve.

9. Heqja e materialeve te teperta nga germimi

I gjithë materiali i tepert i germuar nga Kontraktuesi do te largohet ne vendet e aprovuara. Kur eshte e nevojeshme te transportohet material mbi rruget ose vende te shtruara, Kontraktuesi duhet ta siguroje mos derdhjen e ketij materiali ne rruge ose ato vende te shtruara.

10. Pershkrimi i cmimit njesi per germimet

Cmimi njesi i zerave te punes per germimet do te perfshine, por nuk do te kufizohen per germime ne te gjitha gjeresine dhe thellesine, me çdo mjet qe te jete i nevojshem, duke perfshire germime me dore, nen apo mbi nivelin e ujrave nentoksore, ose nivelin e ujrave siperfaqesore, perfshire perzierje dheu te cdo lloji, mbeshtetset, perforcimin ne te gjitha thellesite dhe gjeressite, me cdo lloj mjete qe te jete nevoja, perfshire edhe germimet me dore, dhe do te perfshije largimin e ujrave nentoksore dhe siperfaqesore ne cdo sasi dhe nga cdo thellesi, me cdo mjet te nevojshem, do te perfshije nivelimin, sheshimin, ngjeshjen e formacioneve, proven dhe per cdo pune shtese per mbrojtjen e formacioneve perpara cdo inspektimi, sic specifikohet, largimin dhe grumbullimin e pemeve te prera, rilevimi topografik i kerkuar, vendosja e piketave te perhershme, dhe te atyre te perkoheshme, realizimi i matjeve, sigurimi i instrumentave per tu perdorur nga Mbikqyresi i Punimeve, furnizimi dhe transporti i fuqise puntore, mbajtja e vendit te punes paster dhe ne kushte higjeno-sanitare, dhe cdo nevojte aksidentale e nevojshme per realizimin e Punimeve brenda periudhes se Kontrates dhe pelqimit te Mbikqyresit te Punimeve. Aty ku materiali i germuar eshte perdorur per mbushje, depozitimi duke perfshire dhe transportin ne dhe nga depozitimi, ngarkimin, shkarkimin, transportin me dore, jane perfshire ne cmimin njesi per germimet e mbushjet. Kosto e transportimit te materialit te tepert te germuar deri ne vendin e hedhjes, te aprovuar nga Mbikqyresi i Punimeve, nuk perfshihet ne cmimin njesi te germimit. Kosto e transportimit te materialit te tepert ne vendin e hedhjes mbulohet nen cmimin njesi te transportit te materialeve. Pervet transportimit te materialit te tepert te gjitha llojet e transportit perfshire edhe transportin e materialeve per perforcim, mbulim, pergatitjen e shtratit, etj. perfshihen ne cmimin njesi te germimit. Nese nuk eshte pohuar ndryshe, te gjitha aktivitetet e tjera te pershkruara me siper do te konsiderohen te perfshira ne cmimin njesi te germimit.

11. Matjet

Te gjitha zerat e germimeve do te maten ne volum. Matja e volumit te germimeve do te bazohet ne dimensionet e marra nga vizatimet ne te cilat percaktohen permasat e germimeve. Cdo germim pertej limiteve te percaktuara ne keto vizatime, nuk do te paguhet, nese nuk percaktohet me pare me shkrim nga Mbikqyresi i Punimeve. Megjithate, nese germimi eshte me pak se volumi i llogaritur nga vizatimet, do te paguhet volumi faktik i germimeve sipas matjeve faktike.

III. PUNIME MONTIMI

1. MATERIALET

Materialet Per objektin “Rikonstruksion i Ujesjellesit te qytetit Leskovik (Linja kryesore Kronjeza –Rezervuaret Ujembledhes)” Nj.Adm. Leskovik + Nj.Adm. Qender Leskovik, Bashkia Kolonje duhet te plotesojne standartet shteterore ne fuqi si dhe duhet te jene te certifikuara nga vendet e Komunitetit European per materialet qe vijne nga importi. Ne kete ujesjelles do te perdoren materialet e poshteshenuara:

Tubacionet Polietilen

Per linjat kryesore te Ujesjellesit si dhe per degezimet qe dalin prej ketyre linjave do te perdoren tuba dhe pjese speciale plastike prej materiali Polietileni me densitet te larte (PE 100) + pjese speciale prej çeliku (bashkim i tubacionit plastim me tubacion çeliku ekzistues). Diametrat e tubave do te jene ne funksion te sasise llogaritesse te ujit te pijshem dhe shpejtesise se levizjes. Gjatesia e tubave duhet te jete (6÷12)m per tubat Dn>90mm dhe (50÷200)m per tubat me Dn<90 mm, ndersa diametri dhe spesori duhet te jene sipas te dhenave ne vizatimet teknike dhe ne perputhje me presionin e punes se tubave Pn (10÷16)atm dhe shkallen e Dimensionimit Standart HDPE 112 Standarti EN 12201-2 ISO 4427. Do te perdoren tubacione polietilen me diametra nga Ø140 mm ne standartet me densitet te larte (PE 100), ose te tipit PE 100 E17, E18, B9H, B94H, F08, F11 norma per EN 12201-2, me kufirin e qendrushmerise maksimal i lejuar do te jete 5MPa. Tubat do te jene me presion Pn(10÷16)atm, nme permbajtje ushqimore brenda standarteve te ujit te pijshem. Per linjen kryesore Kronjeza – Rezervuaret Ujembledhes Leskovik do te perdoren tubacione te presionit Pn (10÷16) atm. Jane percaktuar ne projekt diametrat dhe trashesia (spesori) tubacioneve polietilen, standartet e te cilave do te merret si me poshte:

Tub polietilen PE diameter Dn= (variabel)mm, Pn 10 deri 16atm

Ovaliteti i tubave nuk duhet te jete me i madh se 1,5 %. Tubat dhe pjeset Speciale HDPE duhet te plotesojne te gjitha kerkesat e standarteve teknike perkatese si me poshte:

- ▯ PrEN 12201 (Sistemet e tubacioneve Plastike te furnizimit me uje prej Polietileni)
- ▯ ISO 1183 (Matjet e Densitetit te materialit)
- ▯ ISO 3607 (Tolerancat mbi diamterin e jashtem dhe trashesine e mureve)
- ▯ ISO 3663 (Dimensionet e Filanxhave per tubat dhe pjeset speciale te PE)
- ▯ ISO 4440 (Percaktimi i shkalles se rrjedhjes se materialit PE per tubat dhe pjeset speciale)
- ▯ DIN 8075 (Kerkesat e Pergjithshme te Cilesise se Tubave HDPE – Testimi)

Tubat e HDPE 100 per furnizimin me uje duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi e transporti, ngjitje te thjeshte dhe te shpejte, jetegjatesi mbi 30 vjet dhe rezistence ndaj ujit te ngrohte.

Te dhenat mbi diametrin e jashtem te tubit, presionin, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, SDR, viti i prodhimit, etj duhet te jepen te stampuara ne çdo tub.

Kerkesat Teknike per Materialin e Polietilenit

Materiali i Polietilenit prej te cilit do te prodhohen Tubat dhe pjeset speciale te tyre eshte nje produkt hidrokarbur me formule kimike CH₂-CH₂. Ky material duhet te jete i sigurt per shendetin njerezve dhe i aprovuar nga institucionet perkatese ligjore si IIP, DVGW apo institute te tjera ekuivalente te afta dhe te aprovuara per testimin e cilesise se materialeve plastike.

Vetite e Materialit te HDPE duhet te jene si me poshte:

Densiteti > 0,92-0.93 g/cm³

Koeficienti i zgjerimit linear 0,13 mm / m * K

Konduktiviteti Termik ne 20 grade celsius 0,38W / m * K

Indeksi i Rrjedhjes MFI ne 190 grade celsius/50 N0,4-0,5 g/ 10 min

Sforcimet 25 N/mm³

Rezistenca Siperfaqesore >10 x 10¹⁴ Omega

Shkalla e rrjedhshmerise 127 grade celsius
Terheqja ne thyerje > 500 %
Moduli i perfshirjes ne kthime apo perkulje 800 N/mm²

Dokumentacioni Teknik Shoqerues:

Vendet nga ku do te furnizohen tubacionet polietilen do te jene te çertifikuara nga Komuniteti European. Per kete Kontraktuesit per tubacionet Polietilen HDPE 100 do ti kerkohet qe tubat dhe pjeset speciale duhet te jene te shoqeruar me dokumentacionin teknik perkates te kerkuar nga Standartet e mesiperme si:

- Certifikata e Origjines se mallit nga Prodhuesi i Tubave dhe Pjeseve speciale
- Certifikata e Origjines se prodhimit te materialit te PE nga prodhuesi e shoqeruar me tipin e materialit, llojin dhe te dhenat teknike te pershkruara me siper.
- Certifikata e Cilesise ISO 9001/14001 ose ekuivalente
- Certifikata e Testimit te tubave dhe pjeseve speciale nga Prodhuesi i tyre
- Leja Zyrtare per prodhimin e tubave dhe pjeseve speciale per Prodhuesin
- Manual teknik te Tubave, Pjeseve speciale te prodhuesit dhe te pajisjeve bashkuese te tyre te shoqeruar me manualin e operimit, instalimit, te mirembajtjes si dhe te dhenat teknike te tyre. Per pajisjet duhet te jepen edhe te dhenat e menyres se bashkimit, menyren e ngjitjes, kontrollit dhe testimit gjate procesit te Instalimit.

Aksesoret polietilen:

Do te perdoren aksesore polietilen si bashkues, reduksione e bryla standart sipas diametrave te tubacioneve polietilen qe jane ne projekt me presione deri ne 16 atmosfere. Aksesoret do te jene tipit siç eshte percaktuar ne projekt. Tubacionet polietilen do te lidhen me aksesore polietilen sipas standartit dhe diametrit te tyre. Ne kate rast do te perdoren lidhesa dhe aksesore Pn (10÷16) atmosfere qe i pergjigjet standartit te tubacioneve. Bashkueset do te jene me fileto brenda ose jashte sipas pozicionit te vendosjes se tyre. Te gjithë aksesoret qe do te perdoren jane paraqitur ne projekt e preventiv.

2. VENDOSJA E TUBACIONEVE

Punimet do te realizohen nga punetore te kualifikuar dhe qe kane eksperience ne keto punime, nen Mbikqyrjen e Specialisteve.

2.1 Lidhja e Tubacionit ne linjen kryesore

Tubacioni ne linjen kryesore eshte HDPE 100, Dn=140 mm, Pn16 atm, s=10.8 mm, Weight=4.318 k/m dhe do te bashkohet me ngjitje ballore (saldim plastik) me makineri te posçme qe perdoret per kete qellim ose me bashkim elektrik me ndihmen e rakorderive te veçanta elektrike

2.2 Perkujdesje te ndryshme

Perkujdesja e objekteve ne vendin e punimeve

Perpara fillimit te punimeve shoqeria ndertuese duhet te informohet per pozicionin e te gjitha rrjeteve ekzistuese ne funksion publik siç jane ai i kanalizimeve, sistemi i drenazhimit te ujrave siperfaqesore, kabllot elektrike dhe telefonike, shtyllat elektrike dhe ato te ndricimit, linjat e furnizimit me uje te pijshem apo ujra te tjera, perpara se te filloje hapjen e kanaleve ose gjithë punen, e cila mund te demtojë rrjetet e permendura me siper.

Thellesia e germimeve

Ne baze te diametrit te tubacioneve qe do te perdoren, gjeresia e kanalit do te jete: 65 cm per diametrat nominale perfshire nga $\varnothing(25+160.)$ mm. Hapja e kanalit do te varioje sipas terreneve. Ne te gjitha rastet, dherat do te vendosen nga njera ane e kanaleve, me qellim qe te lehtesohet vendosja e tubave. Perpara provave te rrjetit, çdo bashkim do te lihet dukshem me nje distance jo me pak se 50 cm per çdo bashkim me qellim qe te verifikohet cilesia e lidhjes dhe te gjenden rrjedhjet e mundshme.

Shtresa e dheut te imet nen e mbi tubacionin PE

Per mbrojtjen e tubacionit polietilen nga goditjet mekanike si gure e mbeturina ndertimi, vendosen shtresa dheu te imet te seleksionuar nga germimet. Perdorimi i dheut te imet behet per shkak te veshtiresise te terenit dhe largesis per sigurimin e reres.

Trashesia e shtreses se dheut do te jete:

- 10 cm nen tubacionin PE
- 20 cm mbi tubacionin PE

3. PROVAT E RRJETIT

3.1 Dezinfektim

Per te evituar ndotjen e ujit perpara venies se tubacioneve ne pune ato pastrohen dhe dezinfektohen. Ky proces mbeshtetet ne "Rregulloren Higjeno Sanitare Per Kontrollin e Cilesise se Ujit te Pijshem, Projektimin, Ndertimin, Shfrytezimin dhe Mbilqyrjen e Sistemeve te Furnizimit me Uje te Pijshem", miratuar nga V.K.M, nr.145, date 26.02.1998 .

Pastrimi

Pastrimi behet me uje me shpejtesi te madhe ne sektore me gjatesi qe varet nga mundesia e shkarkimit te linjave. Shperlarja me uje vazhdon per nje kohe jo me pak se 2 ore deri sa uji te dale i paster.

Dezinfektimi

Dezinfektimi i linjave behet solucion klorigjate doza e te cilit merret ne vartesi nga koha e kontaktit. Per nje kohe kontakti te solucionit me tubin prej 8 oresh, doza merret 100 mg/liter, per 12 ore kontakt deri 60 mg/liter, ndersa per 24 ore mund te merret (20+30) mg/liter. Pas kesaj, tubacioni zbrazet nga uji dhe behet perseri shperlarja me uje te paster pa nderprerje per 6 ore deri sa te largohet era e klorit. Pas dezinfektimit dhe shperlarjes te linjave te ujesjellesit behet analiza baktireologjike. Marrja e kampioneve te ujit per analiza baktireologjike behet nga specialistet e sektorit te higjenes dhe Inspektoriatit Sanitar Shteteror.

Miratimi

Miratimi per venien ne pune te linjave te reja behet nga Inspektoriatit Sanitar Shteteror prane Drejtorise se Shendetit Publik Kolonje.

3.2 Provat ne presion te tubacioneve

Mbas montimit te tubave nen toke duhet te kryhet nje test perfundimtar hidraulik i cili teston ngjitjen ballore te tubave dhe njeheresh eliminon demtimet e tubit gjate montimit. Ky test do te kryhet ne nje forme te shpejte brenda 24 oreve ku tubit i krijohet presion mbi 30% mbi standartin qe eshte prodhuar, nese tubi brenda 24 oreve e perballon kete presion ateherë konstatohet se te gjitha lidhjet jane ne rregull dhe nuk eshte demtuar tubi fizikisht. Mbikqyrja e Punimeve lejon mbulimin dhe perdorimin e rrjetit te tubacioneve dhe jep garancine e tij.

Gjate proves se presionit ne pjesen e tubacionit te ri, te gjitha aksesoret duhet te jene te hapur, ndersa degezimet qe ndodhen ne rrjet jane te mbyllura. Masat e meposhtme do te merren per te evituar te gjitha problemet e venies ne pune te ketyre rrjeteve: vendosja ne presion progresiv per me se 1 ore, pikat e larta te rrjetit tashme jane te pastruara nga ajri gjate mbushjes me uje.

Prova teorikisht do te deklarohet e perfunduar nese renia e presionit gjate observimit nuk e kalon shifren 1 bar. Ne rast te kundert, Shoqeria ndertuese duhet te gjeje dhe te riparoje rrjedhjet me qellim qe te arrihet ne nje prove perfundimtare.

5.Transportet

Me qenese eshte teren i thyer malor me rruge te pjesshme, transporti i materialeve te ndertimit dhe tubacionet do te transportohen pjeserisht me krahe. Per kete punonjesit duhet te instruktohen perpara se te fillojne nga puna, kjo jo vetem per sigurine e tyre ne pune, por edhe per mos demtimin e materialeve. Gjithashtu ne trasportet perfshihet ngarkimi dhe transport me shkarkim, me çfaredo mjeti, te materialeve qe rezultojne nga germimet,etj...,te çfaredo natyre dhe lloji, edhe n.q.s eshte i lagur, per largimin e tyre nga kantieri ne çfaredo distance dhe niveli, duke perfshire shkarkimin dhe rrafshimin nese eshte i nevojshem.

6. Pastrimi i sheshit te ndertimit

Pas perfundimit te punimeve behet pastrimi i sheshit te ndertimit nga mbeturinat e kantjerit per ta kthyer sheshin ne gjendjen e mepareshme.

Shenime:

- a. Çdo ndryshim i mundeshem ne projekt do te shoqerohet edhe me ndryshimin e specifikimeve teknike per tju pergjigjur kushteve teknike te projektit dhe zbatimit.
- b. Per çdo ndryshim ne zgjedhjen e materialeve do te behet miratimi nga Projektuesi dhe Investitori me shtese ne Specifikimet Teknike.

Hartoi Specifikimet Teknike

Grupi i projektimit

BOE:LEAD CONSULTING &ARABEL-STUDIO shpk